

KËRKESE
Nr. 682/6, datë 19.6.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Zgjerimi i varrezave të qytetit Fushë-Krujë’”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 624,512 (gjashtëqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekësh.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Krujë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

- Për pasurinë “objekt banimi”, është bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.8.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Krujë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 624,512 (gjashtëqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekë.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I DREJTORISË
SË NEGOCIMIT DHE ASISTENCËS LIGJORE
Denada Dosti

LISTA EMËRORE E PRONARIT, PASURIA E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E TË CILIT SHPRONËSOHET PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE TË QYTETIT FUSHË-KRUJË”

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)							Vlerësimi për shpronësim				Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Vlera totale në (lekë)	
1	Shpetim	Shaban	Babaj	Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	247/3	Arë	2000	4	16	2000	287	574000	574000	
2	Saba	Haxhi	Tali	Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	246/6	Arë	4600	5	56	3	287	861	861	
3	Saba	Haxhi	Tali	Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	246/7	Arë	4000	5	54	173	287	49651	49651	
4	Shtet			Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	385	Rrugë	2800	9	80	1	0	0	0	
5	Shtet			Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	247/1	Arë	1200	7	249	1200	0	0	0	
6	Shtet			Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	247/2	Arë	900	8	1	900	0	0	0	
Vlera totale														624,512	
Çmimet janë marrë nga harta e vlerës, miratuar me VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016															